



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 1337 Prot

Vlorë, më 27 . 7 .2021

VENDIM

Nr. 9 , datë 22 . 07 .2021

**PËR MIRATIMIN E AKT – MARRËVESHJES Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2021
MIDIS KËSHILLIT TË QARKUT VLORË DHE INSTITUTIT TË NDËRTIMIT ME
OBJEKT : “PËR HARTIMIN E PREVENTIVAVE DHE PLANIMETRIVE TË
OBJEKTEVE TË DËMTUARA GJATË VITIT 2018 NË BASHKINË SELENICË SI
REZULTAT I FATKEQËSISË NATYRORE I LLOJIT TËRMET”**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 22 . 07 .2021 në zbatim të nenit 77, pika e të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, përgjigjes së Institutit të Ndërtimit Nr. 1030/1 Prot, datë 25.06.2021 si dhe korrespondencës së vazhdueshme midis Këshillit të Qarkut Vlorë, Bashkisë Selenicë dhe Institutit të Ndërtimit për hartimin e preventivave dhe planimetrive të objekteve të dëmtuara gjatë vitit 2018 në bashkinë Selenicë si rezultat i fatkeqësisë natyrore i llojit tërmet.

VENDOSI :

1. Të miratojë Akt – Marrëveshjen Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2021 me objekt : “Hartimin e preventivave dhe planimetrive të objekteve të dëmtuara gjatë vitit 2018 në bashkinë Selenicë si rezultat i fatkeqësisë natyrore i llojit tërmet nga Instituti i Ndërtimit” me kushte sipas kësaj akt – marrëveshje.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Sektori i Financë, Buxhetit dhe Shërbimeve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYETARI
Ervis Moçka

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. ____ Prot., datë ____ . ____ .2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
KRYETARI

Këshilli i Qarkut Vlorë
Nr. ____ Prot
Vlorë, më datë ____ . ____ .2021

Instituti i Ndërtimit
Nr. ____ Prot
Tiranë, më datë ____ . ____ .2021

AKT - MARRËVESHJE

Sot në Vlorë, më datë ____ . ____ .2021 duke u mbështetur në vullnetin e lirë të palëve, me qëllim "Nëshkrimin e Akt – Marrëveshjes për hartimin e preventivave dhe planimetrive të objekteve të dëmtuara gjatë vitit 2018 në bashkinë Selenicë si rezultat i fatkeqësisë natyrore i llojit tërmet":

PALËT

Këshilli i Qarkut Vlorë , përfaqësuar nga Z. Klaud Gjipali me adresë Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë

Dhe

Institutit të Ndërtimit, përfaqësuar nga Z. Artan Shkreli me adresë : rruga "Myslym Keta", Brarë, Tufinë, Tiranë.

BAZUESHMËRIA LIGJORE

Në mbështetje të :

- Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar;
- Shkronja f, pika 2 dhe shkronja b pika 3 e kreut III të VKM - në 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*"
- VKM – së Nr. 354, datë 11.05.2016 "*Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim m territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim*".

1. OBJEKTI I KËSAJ AKT - MARRËVESHJE

Objekti i kësaj akt – marrëveshje është : Hartimi nga Instituti i Ndërtimit i preventivave dhe planimetrive të objekteve të dëmtuara gjatë vitit 2018 në bashkinë Selenicë si rezultat i fatkeqësisë natyrore i llojit tërmet si dhe dorëzimi pranë Këshillit të Qarkut Vlorë.

2. TË DHËNAT PËR OBJEKTIN



REPUBLICA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
KRYETARI

32 (tridhjetë e dy) objektet e banimit për të cilat kërkohet hartimi i preventivave të detajuar me zëra si dhe i planimetrive përkatëse kanë një shtrirje gjeografike të gjerë në krahinën e Smokthinës, qarku Vlorë. Konkretisht në Njësinë Administrative Brataj, fshati Matogjin janë 10 (dhjetë) objekte banimi; në Njësinë Administrative Brataj, fshati Bashaj janë 7 (shtatë) objekte banimi, 2 (dy) prej të cilave i përkasin lagjes Boder të këtij fshati; në Njësinë Administrative Brataj, fshati Vërmik janë 9 (nëntë) objekte banimi; në Njësinë Administrative Brataj, fshati Lepenicë janë 2 (dy) objekte banimi; në Njësinë Administrative Brataj, fshati Gjorm është 1 (një) objekt banimi; në Njësinë Administrative Armen, fshati Treblovë janë 3 (tre) objekte banimi.

3. QËLLIMI I KËSAJ AKT - MARRËVESHJE

Qëllimi i kësaj akt – marrëveshje konsiston në dorëzimin nga ana e Institutit të Ndërtimit pranë Këshillit të Qarkut Vlorë të materialit të sipërpërmendur.

4. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

- Instituti i Ndërtimit merr përsipër hartimin e 32 (tridhjetë e dy) preventivave të detajuar me zëra si dhe i planimetrive përkatëse.
- Këshilli i Qarkut Vlorë merr përsipër likuidimin e vlerës prej **238 515 (dyqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë me TVSH** sipas shkresës Nr. 1030/1 Prot, datë 25.06.2021.

5. KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën kur nënshkruhet dhe ka efekt deri në dorëzimin e materialit të kërkuar 30 (tridhjetë) ditë sipas detyrës së projektimit.

6. MËNYRA E DORËZIMIT

Vizatimet dhe planimetritë do të jenë në 3 (tre) kopje origjinale, 1 (një) për Këshillin e Qarkut, 1 (një) për bashkinë Selenicë dhe 1 (një) për AKMC – në të cilat do të dorëzohen të gjitha pranë Këshillit të Qarkut Vlorë. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare me postë. Të gjitha materialet do të jenë me firmë dhe vulë origjinale.

7. MËNYRA E PAGESËS



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
KRYETARI

Likujdimi i vlerës së plotë prej **238 515 (dyqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë me TVSH** do të kryhet pas miratimit të kësaj Akt – Marrëveshje në mbledhjen e radhës së Këshillit të Qarkut Vlorë dhe dorëzimit të materialit të kërkuar

Nënshkruhet kjo marrëveshje me vullnet të plotë midis palëve.

**KËSHILLI I QARKUT VLORË
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

**INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Klaud Gjipali

Artan Shkreli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
KRYETARI

Relacion

Në datën 30.05.2018, pranë institucionit të Këshillit të Qarkut Vlorë nga Bashkia Selenicë u paraqitën kërkesat për vlerësim dëmsh nga tërmeti sipas VKM – së 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*, protokolluar pranë këtij institucioni Nr. 2233 Prot, datë 30.05.2018.

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi vlerësoi me seriozitet situatën e paraqitur menjëherë mori masat me ngritjen e grupit të punës dhe daljen në terren për vlerësimin e këtyre dëmeve.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Selenicë si dhe VKM – së së sipërpërmendur u konkludua se ndodhej përpara situatës së shprehur në Kreun III të VKM – së 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*, **“III. Procedura në rastet kur nuk shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore”**.

Gjatë muajit maj 2018, krahina e Smokthinës, qarku Vlorë është goditur vazhdimisht nga tërmete të njëpasnjëshme. Këto tërmete shënuan dëme materiale në fshatrat Gjorm, Bashaj, Lepenicë, Vërmik, Matogjin e Treblovë, pjesë e kësaj krahine. Nga evidentimi në terren nga komisioni i vlerësimit të Këshillit të Qarkut Vlorë u evidentuan dëme të konsiderueshme në një pjesë të objekteve të banimit si dhe dëme të pjesshme në pjesën tjetër për të cilat u bënë vlerësimet sipas përcaktimeve të kreut III, pika ç, dhe përcaktimeve të bëra në paragrafin e dytë të shkronjës ç të pikës 2 të kreut II të VKM – së 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”*.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
KRYETARI

Një pjesë e banesave thuajse u shembën dhe një pjesë u bënë të pabanueshme, duke marrë parasysh edhe faktin që pjesa më e madhe e këtyre banesave janë ndërtime të hershme me konstruksion mur guri me baltë, tavan kompesate si dhe janë banesa të amortizuara ndër vite.

Referuar kësaj komisioni i vlerësimit të dëmeve konkludoi se nuk mund të ndërhyhej për meremetime të pjesshme ndaj vlerësimit të dëmeve të shkaktuara në këto banesa u bë në përputhje me kreun III, pika ç, referuar përcaktimeve të bëra në paragrafin e parë të shkronjës ç të pikës 2 të kreut II të VKM – së 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”* si dhe parashikimi i kostos për dëmshpërbimin e të dëmtuarve u llogarit me sipërfaqen e objektit të dëmtuar herë koston për metër katror referuar VKM – së Nr. 3, datë 28.12.2016 *“Për miratimin e kostove të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”* për qytetin e Vlorës.

Ky dokumentacion së bashku me dokumentacionin mbështetës referuar paragrafit f të pikës 1 të Kreut III të kësaj VKM – je i është përcjellë për vazhdim procedure njësisë së qeverisjes vendore (bashkisë Selenicë) në të cilën institucioni i Këshillit të Qarkut Vlorë shprehet për pamundësi fondesh për dëmshpërblim.

Në vazhdim këto dosje janë rikthyer pranë Këshillit të Qarkut Vlorë për hartimin e preventivave me zëra referuar masës së dëmshpërblimit të pasqyruar në proces verbalet e vlerësimit të këtyre objekteve, kjo sipas pretendimit dhe takimit në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile midis palëve të interesuara.

Në pamundësi të hartimit të këtyre preventivave nga ana e institucionit tonë (planimetri – preventiv) për arsye të mungesës së burimeve njerëzore, Këshilli i Qarkut Vlorë duke vlerësuar maksimalisht situatën problematike dhe me qëllimin e vetëm zgjidhjen e të dëmtuarve ka kërkuar bashkëpunim institucional me Institutin e Ndërtimit për hartimin e tyre.

Nga korrespondenca e kryer midis Këshillit të
dhe Institutit të Ndërtimit si dhe komunikimit

Vlorë, bashkiçë Selenicë
dis / këtyre

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

re.gov.al
e.gov.al
332



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË
KRYETARI

institucioneve u ra dakort parimisht se këto dokumentacione do të hartohen nga Instituti i Ndërtimit kundrejt një vlere në respektim edhe të VKM – së Nr. 354, datë 11.05.2016 *“Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim m territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”*.

Nga ana e Këshillit të Qarkut Vlorë është parë e arsyeshme lidhja e një që akt – marrëveshje me Institutin e Ndërtimit ashtu siç kërkohet edhe nga ky i fundit në korrespondencat e vazhdueshme me një afat 30 (tridhjetë) ditor për përcaktimin e detyrimeve midis palëve me qëllim finalizimin e këtij procesi dhe zhdëmtimin e të dëmtuarëve nga Njësia e Qeverisjes Vendore, Bashkia Selenicë.

Pas përfundimit të kësaj faze në mbështetje edhe të paragrafit f të pikës 1 të Kreut III të VKM – së 329, datë 16.05.2012 *“Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”* preventivat dhe planimetritë do t’i përcillen për kompetencë për vazhdim procedure njësisë së qeverisjes vendore (bashkisë Selenicë).

**Specialist i Shërbimeve, Transportit, fatkeqësive Natyrore, Mjedisit,
Ushqimit dhe Shëndetësisë.**

Muhedin Bego